

VENDIM
Nr. 9, datë 10.1.2018

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS
SË SHOQËRISË HYDRO POWER PLANT OF KORÇA SHPK, PËR VENDOSJE
TË HIPOTEKËS MBI SENDET E PALUAJTSHME TË SHOQËRISË, PRANË INTESA
SANPAOLO BANK

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të pikës 1.3 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., për vendosje të hipotekës mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 139, datë 6.9.2017, vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., për vendosje të hipotekës mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.

2. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit dhe sendet e luajtshme.

- ERE, me shkresën nr. 569/1 prot., datë 13.9.2017, ka njoftuar shoqërinë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., për vendimmarrjen e sipërcituar dhe ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar nga ky subjekt, brenda dy muajve, sipas përcaktimit të nenit 10, pika 2, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

- Shoqëria Hydro Power Plant of Korça sh.p.k. paraqiti në ERE plotësim të dokumentacionit të munguar, sa i përket nenit 7, pika 3 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit” dhe, me shkresën nr. 703 prot., datë 7.12.2017, kërkoi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së saj, me 7 ditë.

- Në vijim, me shkresën nr. 705 prot., datë 11.12.2017, shoqëria Hydro Power Plant of Korça sh.p.k. depozitoi në ERE plotësimin e dokumentacionit për nenin 7, pika 1, germa “i”, me shkresën e Intesa Sanpaolo Bank, me nr. 17/61180 prot., datë 7.12.2017.

- Pas depozitimit të të gjithë dokumenteve të munguar, aplikimi i shoqërisë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë :

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë Hydro Power Plant of Korça sh.p.k., për vendosje të hipotekës, mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë, pranë Intesa Sanpaolo Bank (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

LISTA E KOLATERALIT QË DO TË BLOKOHET NË HIPOTEKË, NË FAVOR TË INTESA
SANPAOLO BANK ALBANIA, PËR KREDINË E PROJEKTTT TË HEC VERBE-SELCËS

Me poshte eshte lista e kolateralit te pasurive te patundshme qe do te barresohen ne hipoteke ne favour te INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA per efekt te marrjes se kredise per projektin e HEC te Verbe - Selces.

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2, Fq. 216

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **501/2**

Lloji i pasurise "are 190 m² dhe "truall" 45.2 m².

1. Kalon traseja e tubacionit te mbuluar te turbines HEC Verba 1;

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2 Fq. 222

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **496/4**

Lloji i pasurise Truall 331.3 m² , siperfaqe totale 1400 m².

Kalon tubacioni nentokesor dhe veprat hidroteknike te HEC Verba 1

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 1, Vol 2 Fq. 219

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **502/2**

Lloji i pasurise totale 140 m², truall 37.6 m²

Kalon tubacioni nentokesor dhe veprat hidroteknike te HEC Verba 1

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 2 dhe nenstacioni, Vol 2 Fq. 214

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **720/2**

Lloji i pasurise Truall 1000 m².

Eshte vendosur ndertesa e HEC Verba 2 me siperfaqe 290 m² me agregatet turbine gjenerator dhe nenstacioni ngrites 10/35 kV me te gjitha pajisjet e tij.

Kartela e pasurise se paluajtshme HEC Verba 2, Vol 2 Fq. 226

Zona kadastrale 3279 , Nr i pasurise **720/3**

Lloji i pasurise Truall 940 m².

Jane vendosur kanali derivacionit, baseni presionit dhe tubacioni netokesor i turbines 2300 m te HEC Verba 2.